LIGJ
Nr. 96/2026

PËR DISENJOT[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton:
1. Rregullat, kriteret dhe procedurat për regjistrimin e disenjove;
2. Të drejtat që rrjedhin prej regjistrimit të disenjove;
3. Rregullimin e disenjove si objekte të pronësisë dhe procedurat për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e disenjove;
4. Rregullat, kushtet e procedurat për heqjen dorë dhe pavlefshmërinë e disenjove;
5. Mbrojtjen e të drejtave të disenjove në rastet e shkeljes së tyre.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave dhe rregullimi i marrëdhënieve juridike që lidhen me disenjot në territorin e Republikës së Shqipërisë

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:
a) kërkesat për regjistrimin e disenjove;
b) disenjot e krijuara;
c) regjistrimet ndërkombëtare të disenjove.

Neni 4
Përkufizime

---

[1] *Ky ligj përafron:*
- plotësisht direktivën (BE) 2024/2823 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 tetor 2024 për mbrojtjen ligjore të disenjove; Fletore Zyrtare seria L, 2024/2823, 18.11.2024, ELI: http://data.europa.eu/eli/dir/2024/2823/oj, CELEX number: 32024L2823;
- pjesërisht rregulloren (BE) 2026/715 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 11 mars 2026, mbi dizenjot e Bashkimit Evropian (kodifikimi) (Tekst me rëndësi për EEA-në). Fletore Zyrtare seria L, 2026/715, ELI: http://data.europa.eu/eli/reg/2026/715/oj;
- plotësisht direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 29 prill 2004 për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. (Tekst me rëndësi për EEA-në) Fletore Zyrtare seria L 157, 30.4.2004, fq.. 45–86, CELEX number: 32004L0048.

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "**Autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm**" është autoriteti kompetent për mbikëqyrjen, monitorimin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe me çdo ligj apo akt nënligjor tjetër, që përmban dispozita për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

2. "**Bordi i apelit**" është organi i krijuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për pronësinë industriale, kompetent për shqyrtimin e ankimeve administrative, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.

3. "**Buletini i DPPI-së**" është botimi periodik zyrtar i DPPI-së, ku botohen të gjitha të dhënat për disenjot, si dhe të gjitha veprimet që lidhen me to, siç parashikohen në këtë ligj dhe në rregulloret që nxirren në bazë të tij.

4. "**Data e prioritetit**" është data e depozitimit të aplikimit të parë për të njëjtën disenjo, i paraqitur në një shtet anëtar të Konventës së Parisit ose të marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, me kusht që prioriteti të kërkohet në mënyrë të vlefshme në aplikimin e mëvonshëm për disenjot, brenda 6 muajve nga depozitimi i parë.

5. "**Disenjo**" është pamja e tërësisë apo e një pjese të një produkti, që rezulton nga karakteristikat, veçanërisht nga linjat, konturet, ngjyrat, forma, tekstura dhe/ose materialet e vetë produktit dhe/ose dekorimit të tij, duke përfshirë lëvizjen, ndryshimin apo çdo lloj tjetër animimi të këtyre karakteristikave.

6. "**Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)**" është institucion publik jobuxhetor, që funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe regjistron, administron dhe promovon objektet e pronësisë industriale, përfshirë disenjot e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Organizimi dhe funksionimi i DPPI-së përcaktohen në legjislacionin në fuqi për pronësinë industriale.

7."**Deklarata e krijuesit**" është një deklaratë me shkrim, e nënshkruar nga krijuesi, që identifikon krijuesin e vërtetë të disenjos, kur aplikanti nuk është i njëjti me të.

8."**Ekspozitë ndërkombëtare zyrtare apo e njohur zyrtarisht**" është ekspozita apo panairi në kuptimin e përdorur në konventën "Për ekspozitat ndërkombëtare", e miratuar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme.

9."***Ex-officio***" është e drejta që ka një person për shkak të pozicionit zyrtar që mban.

10. "**Gjykata kompetente**" është gjykata kompetente për objektet e pronësisë industriale, sipas rastit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

11. "**Kërkesë për regjistrim disenjoje**" ose "Kërkesë për disenjo" është kërkesa për regjistrimin e një disenjoje që depozitohet në DPPI në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

12. "**Klasifikimi i Lokarnos**" është klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale, në funksion të regjistrimit të disenjove industriale, i miratuar me marrëveshjen e Lokarnos "Për krijimin e klasifikimit ndërkombëtar të disenjove industriale", më 8 tetor 1968, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 33/2018 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lokarnos 'Për përcaktimin e një klasifikimi ndërkombëtar për disenjot industriale'".

13. "**Konventa e Parisit**" është Konventa për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale, e miratuar në Paris më 20 mars 1883, me të gjitha rishikimet dhe ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 8993, datë 30.1.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale".

14. "**Konventa për Ekspozitat Ndërkombëtare**" është Konventa për Ekspozitat Ndërkombëtare dhe protokollet e kësaj konvente, e nënshkruar në Paris më 22 nëntor 1928, me të gjitha ndryshimet e mëvonshme, aderuar me ligjin nr. 9899, datë 10.4.2008, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Ekspozitat Ndërkombëtare".

15. "**Licencë ekskluzive**" është licenca nëpërmjet së cilës aplikanti me autorizim të pronarit ose pronari i disenjos autorizon vetëm të licencuarin, duke përjashtuar edhe vetë pronarin që të përdorë disenjon në mënyrën e autorizuar në licencë.

16. "**Licencë joekskluzive**" është licenca që nuk i heq të drejtën aplikantit ose pronarit të disenjos që ta përdorë vetë disenjot ose ta licencojë te persona të tjerë.

17. "**Licencim**" është dhënia e licencës nëpërmjet së cilës aplikanti ose pronari i disenjos (licencuesi) autorizon dhe lejon palën tjetër (të licencuarin) të kryejë çdo akt apo veprim në lidhje me kërkesën për disenjo ose disenjon, siç përcaktohet në këtë ligj.

18. "**Mbajtës i të drejtave të disenjos**" është pronari ose mbajtësi i licencës së disenjos, i regjistruar në kuptim të këtij ligji, edhe çdo person ose entitet tjetër i autorizuar për të përdorur disenjon.

19. "**Mbajtës/tregtar i mallrave pirate**" është personi që ka në posedim ose në pronësi dhe/ose tregton mallra pirate apo që ka të drejta të ngjashme për tjetërsimin/shkatërrimin ose kontrollin fizik të këtyre mallrave, me përjashtim të mallrave të mëposhtme:

a) mallra të natyrës jotregtare, që ndodhen në posedimin dhe/ose pronësinë e një individi;

b) mallra të cilat janë prodhuar nga një person, me pëlqimin e mbajtësit të së drejtës, apo mallra që janë prodhuar nga një person i autorizuar ligjërisht nga mbajtësi i së drejtës për prodhimin e një sasie të caktuar të mallrave, në tejkalim të sasive, për të cilat është rënë dakord ndërmjet personit në fjalë dhe mbajtësit të së drejtës.

20. "**Mallra pirate**" janë mallra të cilat janë objekt i një veprimi që shkel të drejtat e një disenjoje industriale në Republikën e Shqipërisë dhe janë/ose përmbajnë kopje të bëra pa pëlqimin e mbajtësit të të drejtave të lidhur me disenjon industriale apo të një personi të autorizuar prej mbajtësit në vendin e prodhimit.

21. "**Marrëveshja e Hagës**" është marrëveshja për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale e vitit 1960, ratifikuar me ligjin nr. 9648, datë 27.11.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Hagës, të marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të projekteve industriale, 1960".

22. "**Marrëveshja TRIPS**" është marrëveshja për aspektet e lidhura me tregtinë e të drejtave të pronësisë intelektuale, e nënshkruar në Marok më 15 prill 1994, si shtojcë e marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, ratifikuar me ligjin nr.9950, datë 10.7.2008, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e 'Marrëveshjes së Trips-it (aspekte të tregtisë që lidhen me pronësinë intelektuale)'".

23. "**Person**" është çdo person fizik ose juridik.

24. "**Përdoruesi i informuar**" është një person, i cili nuk konsiderohet as konsumator mesatar dhe as ekspert i disenjove, por që ka njohuri të veçanta për sektorin përkatës të disenjove, është mjaftueshëm vëzhgues dhe ka njohuri për disenjot ekzistuese, të fituara përmes përdorimit të produkteve ose interesit për to, duke e bërë atë një person që shërben si pikë reference për vlerësimin e karakterit individual të disenjos.

25. "**Produkt**" është çdo artikull industrial ose artizanal, përveç një programi kompjuterik, pavarësisht nëse ai është i trupëzuar në një objekt fizik apo materializohet në një formë jofizike, duke përfshirë:

a) paketimin, grupet e artikujve, organizimet në hapësirë të artikujve, të synuar për të formuar një mjedis të brendshëm ose të jashtëm dhe pjesët e synuara për t'u montuar në një produkt kompleks;

b) veprat ose simbolet grafike, logot, motivet sipërfaqësore, stilet tipografike dhe ndërfaqet grafike të përdoruesit.

26. "**Produkt kompleks**" është një produkt që përbëhet nga shumë komponentë, të cilët mund të zëvendësohen duke bërë të mundur çmontimin dhe rimontimin e produktit.

27. "**Regjistër**" është mbledhja zyrtare e të dhënave për disenjot që mbahen nga DPPI-ja në përputhje me këtë ligj.

28. "**Rregullorja për disenjot**" është rregullorja për disenjot, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

29. "**Sistemi i administrimit të pronësisë industriale**" (SAPI) është sistemi elektronik, duke përfshirë bazën e të dhënave për administrimin e pronësisë industriale nga DPPI-ja.

30. "**Traktati i Riadit**" është Traktati Ndërkombëtar për Disenjon Industriale, i nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 10 korrik 2025.

31. "**Zyra ndërkombëtare**" është zyra ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

32. "**OBPI**" është Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, e themeluar nëpërmjet Konventës për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, e nënshkruar në Stokholm më 14 korrik 1967, aderuar me ligjin nr. 8993, datë 30.1.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale".

33. "**EUIPO**" është zyra e pronësisë intelektuale të Bashkimit Evropian, e cila menaxhon regjistrimin e disenjove evropiane, të vlefshme në të gjithë territorin e Bashkimit Evropian.

PJESA II
KUSHTET DHE E DREJTA E MBROJTJES

KREU I
FITIMI I TË DREJTAVE PËR DISENJON

Neni 5
Kërkesat për mbrojtjen e disenjos

1. Për të fituar mbrojtje, një disenjo duhet të jetë e re dhe të ketë karakter individual. Një disenjo e ndërthurur ose e aplikuar në një produkt, që është pjesë përbërëse e një produkti kompleks, mund të vlerësohet e re dhe të ketë karakter individual:

a) në qoftë se pjesa përbërëse, pasi ndërthuret me produktin kompleks, mbetet e dukshme gjatë përdorimit normal të këtij të fundit. "Përdorim normal" do të thotë përdorimi nga konsumatorët, përjashtuar mirëmbajtjen, shërbimet ose punët riparuese;

b) në masën që këto tipare të dukshme të pjesës përbërëse i përmbushin në vetvete kërkesat e risisë dhe karakterin individual.

2. E drejta për disenjo nuk ekziston në rast të tipareve të pamjes së jashtme të një produkti, të cilat:

a) diktohen vetëm nga funksionimi i tij teknik;

b) duhet të riprodhohen domosdoshmërish në formën dhe përmasat e tyre të sakta për të bërë të mundur që produkti ku është përfshirë disenjoja ose tek i cili disenjoja është aplikuar të jetë i lidhur mekanikisht apo i vendosur përreth apo përkundrejt një produkti tjetër, në mënyrë që secili produkt të mund të kryejë funksionin e vet.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni, e drejta për disenjot, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji, ekziston në një disenjo që i shërben qëllimit për të lejuar bashkimin e shumëfishtë ose lidhjen e produkteve, që alternohen në mënyrë të ndërsjellë në një sistem modular.

Neni 6
Risia dhe karakteri individual

1. Një disenjo përbën risi nëse asnjë disenjo identike me të nuk i është bërë e njohur publikut përpara datës së depozitimit të kërkesës për regjistrimin e disenjos ose kur pretendohet për prioritet përpara datës së prioritetit. Disenjot konsiderohen identike nëse karakteristikat e tyre ndryshojnë vetëm në elemente të parëndësishme.

2. Një disenjo konsiderohet se ka karakter individual kur përshtypja e përgjithshme që ajo lë te një përdorues i informuar ndryshon nga përshtypja që ky përdorues merr nga çdo disenjo e bërë publike më parë. Krahasimi bëhet me disenjot e njohura për publikun para datës së depozitimit të kërkesës për regjistrim. Kur pretendohet për prioritet, krahasimi bëhet me disenjot e njohura përpara datës së prioritetit.

3. Në vlerësimin e karakterit individual të disenjos merret parasysh shkalla e lirisë së krijuesit të disenjos në zhvillimin e saj.

Neni 7

Bërja publike

1. Për qëllime të zbatimit të nenit 6 të këtij ligji, një disenjo konsiderohet se i është bërë e njohur publikut nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) është publikuar pas regjistrimit apo nëse është zbuluar në ndonjë formë tjetër ose;

b) është publikuar pas ekspozimit, përdorimit në tregti ose pasi është bërë publike në një mënyrë tjetër, përveçse kur ka qenë e pamundur, në mënyrë të arsyeshme, që këto ngjarje t'i bëheshin të njohura sektorit përkatës që operon në Republikën e Shqipërisë, ose pas aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në territorin e Bashkimit Evropian, përpara datës së dorëzimit të kërkesës për regjistrim, ose kur pretendohet prioriteti përpara datës së prioritetit. Disenjoja nuk konsiderohet e bërë e njohur për publikun për faktin e vetëm se i është bërë e ditur një personi të tretë në kushte të shprehura ose të nënkuptuara konfidencialiteti.

2. Bërja publike nuk merret në konsideratë për qëllimin e zbatimit të nenit 6 të këtij ligji nëse disenjoja, e cila është identike ose lë një përshtypje të përgjithshme të njëjtë me disenjon për të cilën kërkohet mbrojtje në bazë të një të drejte disenjoje të regjistruar, i është bërë e njohur publikut:

a) nga krijuesi i disenjos, përfituesi i të drejtave ose një person i tretë, si rezultat i informacionit të dhënë nga/një veprim i ndërmarrë nga krijuesi i disenjos ose nga përfituesi i të drejtave;

b) brenda periudhës prej 12 muajve përpara datës së depozitimit të kërkesës ose kur pretendohet për prioritet përpara datës së prioritetit.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet edhe nëse disenjoja është bërë e njohur për publikun, si pasojë e një veprimi abuzues kundër krijuesit ose përfituesit së të drejtave.

Neni 8

E drejta për mbrojtje

1. E drejta ekskluzive për një disenjo sipas këtij ligji përfitohet me regjistrimin në DPPI.

2. E drejta ekskluzive e pronësisë së një disenjoje i përket krijuesit ose përfituesit të të drejtave. Në rast se janë dy ose më shumë krijues, ata kanë të drejta të barabarta, përveçse kur janë dakordësuar ndryshe në marrëveshjen ndërmjet tyre.

3. E drejta për mbrojtjen e një disenjoje i përket aplikantit që ka depozituar një kërkesë me datë më të hershme depozitimi ose, kur pretendohet për prioritet, me datë më të hershme prioriteti nëse dy apo më shumë kërkesa janë regjistruar nga persona të ndryshëm për të njëjtën disenjo të krijuar në mënyrë të pavarur.

4. Në rast se aplikanti dhe krijuesi nuk janë i njëjti person, aplikanti duhet të dorëzojë së bashku me kërkesën edhe deklaratën e krijuesit, sipas së cilës krijuesi pranon se aplikanti do të gëzojë të gjitha të drejtat për disenjon e regjistruar në përputhje me këtë ligj.

5. Mbrojtja e disenjos garantohet për ato karakteristika të pamjes së një disenjoje të regjistruar, të cilat shfaqen në mënyrë të dukshme në kërkesën për regjistrim.

Neni 9

Disenjoja e krijuar me porosi ose nga një punëmarrës

1. Kur një disenjo është porosi përmes një kontrate porosie, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të ofruesit të shërbimit ose duke ndjekur udhëzimet e porositësit, e drejta për mbrojtjen e saj i përket porositësit, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratën e porosisë.

2. Kur një disenjo është krijuar me kontratë pune, në kuadër të kryerjes së detyrave të punëmarrësit ose duke ndjekur udhëzimet e punëdhënësit, e drejta për mbrojtjen e saj i përket punëdhënësit, përveçse kur parashikohet ndryshe në kontratën e punës apo në legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës.

3. Kur një disenjo ka një vlerë ekonomike shumë më të madhe se ajo e parashikuar nga palët në kohën e nënshkrimit të kontratës së punës, punëmarrësi ka të drejtën e një kompensimi të veçantë. Në mungesë të marrëveshjes midis palëve, shuma e kompensimit përcaktohet nga gjykata.

4. Punëmarrësi që ka krijuar një disenjo në përputhje me pikën 5 të këtij neni duhet t'i paraqesë menjëherë punëdhënësit një deklaratë me shkrim për disenjon që ndodh brenda 4 muajve.

5. Kur një punëmarrës, i cili në bazë të kontratës së punës nuk është i detyruar të merret me veprimtari krijuese, krijon një disenjo, duke përdorur të dhëna ose mjete të tjera që janë bërë të njohura ose të mundshme nëpërmjet punësimit në fushën e veprimtarisë së punëdhënësit, njofton menjëherë punëdhënësin me një raport me shkrim për disenjon. E drejta për mbrojtjen e kësaj disenjoje i takon punëmarrësit, me përjashtim të rasteve kur:

a) nga data në të cilën i është paraqitur deklarata me shkrim punëdhënësi nuk ka shprehur interes për disenjon; ose

b) nga data kur punëdhënësi është njoftuar për disenjon në mënyra të tjera, cilado qoftë më e hershme, punëdhënësi e njofton punëmarrësin me një deklaratë me shkrim se është i interesuar për disenjon.

6. Nëse brenda periudhës së përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 5 të këtij neni punëdhënësi bën një deklaratë me shkrim duke shprehur interes për disenjon, e drejta për mbrojtjen e saj i takon punëdhënësit që nga fillimi, ndërsa punëmarrësi ka të drejtë të kompensohet në varësi të pagës, të vlerës ekonomike të disenjos dhe të fitimit që merr punëdhënësi nga disenjoja. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, shuma e kompensimit vendoset nga gjykata.

7. Çdo kontratë që është më pak e favorshme për punëmarrësin sesa parashikohet në këtë nen është e pavlefshme.

Neni 10

Emri i krijuesit

1. Për çdo botim që DPPI-ja kryen për disenjon, duhet të përmendet emri i krijuesit apo i krijuesve, përveçse kur krijuesi kërkon nëpërmjet deklaratës së krijuesit që emri i tij të mos përmendet.

2. Nëse disenjoja është rezultat i punës në grup, përmendja e grupit mund të zëvendësojë përmendjen e krijuesve individualë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën për të regjistruar një ndryshim të emrit të krijuesit ose të grupit në regjistër.

3. Personi në emër të të cilit është regjistruar e drejta e disenjos ose para regjistrimit personi në emër të të cilit është depozituar kërkesa për regjistrim konsiderohet si personi që ka të drejtë të veprojë për çdo procedurë pranë DPPI-së, si dhe për çdo procedurë tjetër.

Neni 11

Refuzimi i regjistrimit të disenjos për shkaqe absolute

1. Regjistrimi i një disenjoje refuzohet nga DPPI-ja kur disenjoja:

a) nuk është në përputhje me përcaktimin e pikës 5 të nenit 4 të këtij ligji;

b) është në kundërshtim me rendin publik ose me parimet e pranuara të moralit; ose

c) përmban një stemë, flamur ose emblemë kombëtare, emrin ose shkurtimin e emrit të një vendi apo të një organizate ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë lejohet nga autoritetet shtetërore përgjegjëse ose nga organizatat ndërkombëtare të sipërpërmendura;

ç) përmban tërësisht apo pjesërisht riprodhim të elementeve të trashëgimisë kulturore që konsiderohen me rëndësi kombëtare, përveçse kur regjistrimi është i autorizuar nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në përputhje me ligjet në fuqi.

2. Në rastet e listuara në pikën 1, shkronjat "b", "c" dhe "ç", të këtij neni, disenjoja mund të regjistrohet në një formë të ndryshuar nëse në atë formë ajo përputhet me kërkesat për mbrojtjen, si dhe ruhet identiteti i disenjos.

KREU II

PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË DISENJOS

Neni 12

Përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e disenjos

1. Kërkesa për regjistrimin e një disenjoje përmban:

a) formularin e nënshkruar, i cili përmban:

i. emrin dhe adresën e kërkuesit;

ii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar, nëse kërkesa bëhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;

iii. treguesin e produktit në të cilin disenjoja është e përfshirë ose për të cilin do të aplikohet;

iv. përshkrimin e disenjos;

v. klasifikimin e produkteve në të cilat disenjoja është e përfshirë ose për të cilat do të aplikohet, sipas klasifikimit të Lokarnos;

vi. të dhënat identifikuese të krijuesit ose të krijuesve të disenjos;

vii. elemente të tjera të përcaktuara në rregulloren për disenjot;

b) një paraqitje mjaftueshëm të qartë të disenjos, që lejon përcaktimin e saktë të objektit për të cilin kërkohet mbrojtja, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse;

c) autorizimin e përfaqësimit, nëse kërkesa bëhet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar;

ç) deklaratën që autorizon kërkuesin ta regjistrojë disenjon, kur kërkuesi nuk është krijuesi;

d) një dokument që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës së depozitimit të kërkesës për regjistrim sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

2. Treguesi i produkteve, i përmendur në nënndarjen "iii", të shkronjës "a", të pikës 1 të këtij neni, nuk ndikon objektin e mbrojtjes së disenjos. Kjo vlen, gjithashtu, edhe për përshkrimet në të cilat shpjegohet paraqitja e disenjos, si dhe për çdo lloj përjashtimi përgjegjësie në formë verbale të përfshirë në to.

3. Kërkesa për regjistrimin e një disenjoje në portalin qeveritar "*e-Albania*" mund të përmbajë një deklaratë ku pretendohet për prioritet dhe të gëzojë një të drejtë prioriteti, kur ai është i njëjtë me një kërkesë të mëparshme e të rregullt kombëtare, të depozituar nga kërkuesi ose zëvendësuesi i tij ligjor sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji. Kërkesë e rregullt kombëtare quhet çdo kërkesë, e cila ka plotësuar kushtet e nevojshme për të marrë një datë depozitimi, pavarësisht se çfarë ka ndodhur më vonë me të. Në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, e drejta e prioritetit, e fituar si më sipër, sjell pasojë që data e prioritetit të konsiderohet si datë depozitimi e disenjos së regjistruar pranë DPPI-së.

4. Deklarata që pretendon prioritet depozitohet brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrim, duke përcaktuar datën e depozitimit dhe numrin e kërkesës së mëparshme, zyrën në të cilën është depozituar, si dhe duke ngarkuar në portalin qeveritar "*e-Albania*" një kopje të kërkesës së mëparshme. Në të kundërt, e drejta e prioritetit humbet.

5. Forma e paraqitjes së kërkesës, elementet e tjera të formularit, dokumentacioni dhe procedura për dorëzimin e saj përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 13

Data e depozitimit

1. Data e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e një disenjoje caktohet data kur DPPI-ja merr në dorëzim kërkesën në sistemin e administrimit të pronësisë industriale, e cila paraprakisht përmban formularin e nënshkruar të kërkesës për regjistrim të disenjos, të dhënat identifikuese të kërkuesit, një paraqitje mjaftueshëm të qartë të disenjos, e cila lejon përcaktimin e objektit për të cilin kërkohet mbrojtja, me kusht që brenda 2 muajve nga kjo datë kërkuesi të plotësojë kërkesën për regjistrim me të gjitha elementet e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "d", të pikës 1, të nenit 12 të këtij ligji.

2. Në rast se brenda afatit 2-mujor, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kërkuesi nuk plotëson të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, DPPI-ja refuzon kërkesën për regjistrim të disenjos.

Neni 14

Paraqitja e disenjos

1. Disenjoja paraqitet në çdo formë të riprodhimit vizual, bardhezi ose me ngjyra. Riprodhimi mund të jetë statik, dinamik ose i animuar dhe realizohet me çfarëdolloj mjeti të përshtatshëm, duke përdorur teknologjinë përgjithësisht të disponueshme, duke përfshirë skicat, fotografitë, videot, imazhet kompjuterike ose modelimin kompjuterik.

2. Riprodhimi duhet të tregojë të gjitha aspektet e disenjos për të cilat kërkohet mbrojtje nga një ose disa pamje. Gjithashtu, mund të ofrohen edhe pamje të tjera, me qëllim për të detajuar më tej karakteristikat specifike të disenjos.

3. Kur paraqitja përmban riprodhime të ndryshme të disenjos ose përfshin më shumë se një pamje, ato duhet të përputhen me njëra-tjetrën dhe objekti i regjistrimit duhet të përcaktohet nga kombinimi i të gjitha karakteristikave vizuale të këtyre pamjeve ose riprodhimeve së bashku.

4. Disenjoja paraqitet e vetme, pa përfshirë elemente të tjera.

5. Elementet për të cilat nuk kërkohet mbrojtje do të cilësohen me anë të përjashtimeve në formë vizuale. Çdo përjashtim vizual i tillë duhet të përdoret në mënyrë të qëndrueshme.

6. Kriteret dhe elementet që duhet të përmbushë aplikanti për paraqitjen e disenjos, si dhe mënyra e paraqitjes së disenjos, do të përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 15

Klasifikimi dhe treguesit e produktit

1. Produktet për të cilat kërkohet të regjistrohet një disenjo klasifikohen sipas klasifikimit të Lokarnos në fuqi, në datën e paraqitjes së kërkesës.

2. Treguesi i produktit duhet të identifikojë qartë dhe saktë natyrën e produkteve dhe të mundësojë klasifikimin e secilit produkt vetëm në një klasë dhe nënklasë të klasifikimit të Lokarnos, nëse është e mundur, duke përdorur bazën e të dhënave të botuara nga DPPI-ja. Treguesi i produktit duhet të përputhet me paraqitjen vizuale të disenjos.

3. Produktet do të grupohen sipas klasave të klasifikimit të Lokarnos, ku çdo grup do të paraprihet nga numri i klasës përkatëse dhe do të paraqitet sipas rendit të klasave dhe nënklasave në atë klasifikim.

4. Nëse aplikanti përdor tregues produktesh që nuk gjenden në bazën e të dhënave, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, ose që nuk përputhen me paraqitjen e disenjos, DPPI-ja mund të propozojë tregues alternativë nga ajo bazë të dhënash. Në rast se aplikanti nuk përgjigjet brenda afatit të përcaktuar nga DPPI-ja, ajo mund të vazhdojë shqyrtimin mbi bazën e treguesve të propozuar.

Neni 16

Kërkesa për regjistrimin e disenjove të shumëfishta dhe ndarja e kërkesës për regjistrimin e disenjos së shumëfishtë

1. Në një kërkesë për regjistrimin e disenjove të shumëfishta mund të përfshihen deri në 50 disenjo. Kjo kërkesë quhet "kërkesë për regjistrimin e një disenjoje të shumëfishtë". Në këtë rast kërkesa nuk i nënshtrohet kushtit që produktet në të cilat synohet të përfshihen ose për të cilat kërkohet të regjistrohen disenjot t'i përkasin të gjitha të njëjtës klasë të klasifikimit të Lokarnos.

2. Paraqitësi i kërkesës mund të ndajë kërkesën e shumëfishtë në dy apo më tepër aplikime, të cilat mund të përmbajnë një ose disa disenjo.

3. Secila kërkesë e ndarë nga kërkesa e shumëfishtë do të ketë si datë depozitimi datën e depozitimit të kërkesës fillestare.

4. Kushtet për ndarjen e kërkesës për regjistrimin e disenjos së shumëfishtë përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 17

E drejta për prioritet

1. Personi që ka depozituar në mënyrë të rregullt një kërkesë për një të drejtë disenjoje në ose për llogari të një shteti palë të Konventës së Parisit ose të marrëveshjes për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë apo pasardhësit e tij në titull gëzon, për qëllimin e depozitimit të një kërkese për

një disenjo të regjistruar në Republikën e Shqipërisë për të njëjtin disenjo, të drejtën e prioritetit për një periudhë 6-mujore, duke filluar nga data e depozitimit të kërkesës së parë.

2. Çdo kërkesë, që sipas ligjit kombëtar të shtetit ku është bërë ose sipas marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe është e vlefshme për të vendosur një datë depozitimi, pavarësisht rezultatit përfundimtar të kërkesës, njihet si bazë për përfitimin e së drejtës së prioritetit.

3. Një kërkesë e mëvonshme për një disenjo, që ka qenë objekt i një kërkese të mëparshme të parë dhe që depozitohet në të njëjtin shtet, konsiderohet si kërkesa e parë për qëllim të përcaktimit të prioritetit, nëse në datën e depozitimit të kërkesës së mëvonshme kërkesa e mëparshme është tërhequr, është braktisur ose është refuzuar pa qenë bërë publike dhe pa lënë pasoja juridike dhe nuk ka shërbyer si bazë për kërkesë për përfitimin e prioritetit. Një kërkesë e tillë e mëparshme nuk mund të përdoret më për të kërkuar të drejtën e prioritetit.

4. Nëse kërkesa e parë është bërë në një shtet që nuk është palë në Konventën e Parisit ose në marrëveshjen për themelimin e Organizatës Botërore të Tregtisë, pikat 1 deri në 3 të këtij neni do të zbatohen vetëm nëse, sipas të dhënave të publikuara zyrtarisht, ky shtet njeh në mënyrë reciproke të drejtën e prioritetit për kërkesat e paraqitura në Shqipëri, sipas kushteve të barasvlershme me këtë ligj. Në raste të tilla, DPPI-ja mund të kërkojë nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme të verifikojë ekzistencën e trajtimit reciprok.

5. E drejta e prioritetit sipas pikës 4 të këtij neni do të zbatohet nga data e publikimit zyrtar të vendimit për trajtimin reciprok dhe do të përfundojë zbatimin nga data e publikimit të vendimit, që vërteton përfundimin e këtij trajtimi reciprok, përveç rasteve kur në njoftim parashikohet një datë më e hershme për hyrjen në fuqi ose për përfundimin.

6. Njoftimet e përmendura në pikat 4 dhe 5 të këtij neni do të publikohen në buletinin zyrtar të pronësisë industriale të DPPI-së.

7. Aplikanti që pretendon prioritet duhet të paraqesë në DPPI një kopje të kërkesës së parë dhe përkthimin e tij në gjuhën shqipe brenda 3 muajve nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e disenjos.

8. Data e prioritetit llogaritet si datë e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e disenjos në Republikën e Shqipërisë, me qëllim që të përcaktohet se cilat të drejta kanë prioritet.

9. Kërkuesi për regjistrimin kombëtar të disenjos, që ka ekspozuar produktet e caktuara, ku përfshihet disenjoja në një ekspozitë zyrtare ose ekspozitë ndërkombëtare të njohur zyrtarisht, mund të pretendojë të drejtë për prioritet nga data e ekspozimit të parë të produkteve, nëse ai depoziton një kërkesë për regjistrim disenjoje në Republikën e Shqipërisë brenda 6 muajve nga kjo datë ekspozimi. Efekti i të drejtës për prioritet llogaritet siç parashikohet në pikën 8 të këtij neni.

10. Kërkuesi që dëshiron të përfitojë nga prioriteti, i përmendur në pikën 9 të këtij neni, duhet të paraqesë një deklaratë prioriteti njëkohësisht me kërkesën për regjistrim brenda 2 muajve nga data e depozitimit të kërkesës. Brenda 3 muajve nga data e paraqitjes së deklaratës së prioritetit, aplikanti duhet të dorëzojë prova që vërtetojnë se produktet përkatëse janë bërë publike në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Certifikata e lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të ekspozitës, e cila përmban datën e ekspozimit për herë të parë të disenjos, si dhe të dhëna për produktin/produktet e ekspozuara, shërben si dëshmi që vërteton paraqitjen e produktit/produkteve në ekspozitë.

Neni 18

Ekzaminimi formal i përmbushjes së kritereve të kërkesës për regjistrimin e disenjos

1. Pas marrjes së kërkesës për regjistrimin e një disenjoje, DPPI-ja ekzaminon nëse kërkesa përmbush të gjitha kriteret e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "d" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji.

a) nëse kërkesa i përmbush këto kritere, ai merr si datë depozitimi datën në të cilën kërkesa është paraqitur në DPPI;

b) nëse kërkesa nuk i përmbush kriteret e shkronjave "a", "b" dhe "d", të pikës 1, të nenit 12 të këtij ligji, DPPI-ja njofton kërkuesin të plotësojë këto kritere brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 13 të këtij ligji:

i. nëse kërkuesi i plotëson kërkesat e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "d", të pikës 1, të nenit 12 të këtij ligji brenda afatit të shkronjës "b", të pikës 1 të këtij neni, DPPI-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke caktuar si datë depozitimi datën e paraqitjes së kërkesës.

ii. nëse plotësimi i kërkesës nuk bëhet brenda këtij afati 2-mujor, DPPI-ja e refuzon kërkesën dhe njofton me shkrim kërkuesin.

2. Brenda 3 muajve nga data e depozitimit të një kërkese për regjistrimin e një disenjoje, DPPI-ja shqyrton kërkesën nëse përmbush kriteret e shkronjave "c" dhe "ç", të pikës 1, të nenit 12 të këtij ligji, si dhe kriteret e pikave 2, 3, 4 dhe 5 të të njëjtit nen.

a) kur kërkesa nuk i përmbush të gjitha këto kritere, DPPI-ja njofton kërkuesin t'i plotësojë ato brenda 2 muajve nga data e njoftimit.

b) nëse kërkuesi nuk i plotëson kriteret brenda afatit, DPPI-ja e refuzon kërkesën dhe njofton kërkuesin.

3. Afati për paraqitjen e plotësimeve sipas pikës 2 të këtij neni zgjatet deri në 2 muaj shtesë nëse kërkuesi paraqet brenda periudhës 2-mujore nga data e marrjes së njoftimit një kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën përkatëse.

Neni 19

Ekzaminimi i shkaqeve absolute për refuzim

1.Brenda 1 muaji nga data e plotësimit të formaliteteve të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, DPPI-ja ekzaminon nëse disenjoja është në përputhje me të gjitha kërkesat e pikave të nenit 11 të këtij ligji. Kur kërkesa është në përputhje me të gjitha këto kritere të neneve të sipërpërmendura, DPPI-ja boton kërkesën për disenjo në buletinin e DPPI-së.

2.Nëse disenjoja nuk është në përputhje me:

a) përkufizimin e disenjos sipas pikës 5, të nenit 4 të këtij ligji;

b) përkufizimin e produktit sipas pikës 25, të nenit 4 të këtij ligji;

c) përkufizimin e produktit kompleks sipas pikës 26, të nenit 4 të këtij ligji;

3. Kërkesa refuzohet nëse kërkuesi nuk parashtron vërejtjet e tij apo nuk depoziton dokumentet shtesë të kërkuara brenda afatit kohor ose nëse DPPI-ja vëren se kërkesa nuk është në përputhje me nenin 11 të këtij ligji edhe pas përgjigjes së kërkuesit. Nëse shkaqet për refuzim kanë të bëjnë vetëm me disa prej disenjove të përfshira në një kërkesë të shumëfishtë, DPPI-ja e refuzon kërkesën vetëm në lidhje me këto disenjo.

4. Vendimi i refuzimit për shkaqe absolute merret nga DPPI-ja vetëm pas ekzaminimit të plotësimit të të metave të kërkesës dhe i njoftohet kërkuesit në llogarinë e tij në portalin qeveritar "*e-Albania*".

Neni 20

Ekzaminimi i kërkesës për regjistrimin e disenjos

1. DPPI-ja ekzaminon kërkesën për regjistrimin e disenjos vetëm për përmbushjen e kërkesave të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

2. Kriteret për risinë dhe karakterin individual nuk ekzaminohen nga DPPI-ja, por nga gjykata kompetente.

Neni 21

Dorëheqja dhe ndryshimi i kërkesës

1. Kërkuesi mund të heqë dorë në çdo kohë nga një kërkesë për regjistrimin e një disenjoje ose në rastin e një kërkesë për disenjo të shumëfishta të tërheqë disa nga disenjot e përfshira në kërkesë.

2. Kërkuesi mund të ndryshojë në çdo kohë, në elemente të parëndësishme, paraqitjen e disenjos për të cilën ka dorëzuar kërkesën.

Neni 22

Rivendosja në afat e të drejtave

1.Personi që ka depozituar kërkesën për regjistrim disenjoje ose mbajtësi i të drejtave të disenjos, si dhe çdo palë tjetër e përfshirë në procedurat përpara DPPI-së, mund të kërkojë rivendosjen në afat të të drejtave nëse:

a) ai nuk ka qenë në gjendje të respektojë një afat ndaj DPPI-së për shkaqe objektive, të pavarura nga vullneti i tij;

b) pengesa për respektimin e afatit ka sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë humbjen e të drejtave sipas këtij ligji.

2. Në kërkesën për rivendosjen në afat jepen shkaqet dhe rrethanat që kanë penguar kërkuesin ose mbajtësin e të drejtave të respektojë afatin. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Kërkesa për rivendosje në afat shoqërohet me pagesën e tarifës përkatëse.

3. Nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, pasojat ligjore që shkaktohen nga mosrespektimi i afatit konsiderohen se nuk kanë ndodhur.

4. Rivendosja në afat nuk lejohet për:

a) kërkesat drejtuar bordit të apelit të DPPI-së;

b) kërkesën për rivendosje në afat sipas këtij neni.

5. Procedura për depozitimin dhe shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat kryhet në mënyrën që përcaktohet në rregulloren për disenjot.

6. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja për rivendosjen në afat mund të bëhet ankim në bordin e apelit përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 23
Ankimi i vendimit të refuzimit

1.Brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës për regjistrim të disenjos, sipas pikës 3, të nenit 19 të këtij ligji, kërkuesi ka të drejtë ta ankimojë vendimin e DPPI-së në bordin e apelit kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

2. Brenda 2 muajve nga data e paraqitjes së ankimit, bordi i apelit njofton kërkuesin për vendimin e marrë.

3. Bordi i apelit ka të drejtë t'i kërkojë kërkuesit të paraqesë dokumente të tjera shtesë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

Neni 24
Regjistrimi i disenjos

1. Kur kërkesa për regjistrimin e disenjos plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe për aq sa nuk është refuzuar në bazë të neneve 11 dhe 12 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon kërkuesit njoftim për të paguar tarifën e regjistrimit të disenjos brenda 1 muaji nga data e marrjes së njoftimit.

2. Nëse kërkesa për regjistrim përmban një kërkesë për shtyrjen e botimit, sipas nenit 26 të këtij ligji, në regjistër do të shënohet kjo kërkesë, si dhe data e përfundimit të periudhës së shtyrjes së publikimit.

3. Nëse tarifa e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni paguhet brenda afatit të caktuar, disenjoja regjistrohet në regjistrin e disenjove dhe botohet në buletinin e DPPI-së. DPPI-ja brenda 2 muajve i lëshon mbajtësit të së drejtave certifikatën për disenjon.

4. Nëse kërkuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda periudhës së caktuar në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja me vendim e refuzon kërkesën për regjistrimin e disenjos.

5. Mbajtësi i së drejtës së një disenjoje të regjistruar mund të njoftojë publikun për regjistrimin e disenjos, duke shfaqur mbi produktin në të cilin përfshihet apo për të cilin kërkohet disenjoja shkronjën "D" brenda një rrethi "(Ⓓ)". Ky njoftim mund të shoqërohet nga numri i regjistrimit të disenjos apo nga *hyperlink*-u që të drejton te regjistrimi i disenjos në regjistër.

6. Të dhënat për publikimin e disenjos, për certifikatën e regjistrimit dhe për simbolin e disenjos së regjistruar parashikohen në rregulloren për disenjot.

Neni 25
Botimi i disenjos së regjistruar

1. DPPI-ja boton në buletinin e radhës disenjon e regjistruar.
2. Të dhënat që botohen në buletinin e DPPI-së përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 26
Shtyrja e botimit

1. Me depozitimin e kërkesës, kërkuesi mund të kërkojë që botimi i disenjos së regjistruar të shtyhet për një periudhë deri në 30 muaj nga data e depozitimit të kërkesës ose, nëse ka një pretendim për prioritet, nga data e prioritetit. DPPI-ja do të nxjerrë një njoftim për shtyrjen e botimit të disenjos së regjistruar.
2. Pas regjistrimit të disenjos dhe shtyrjes së botimit nuk do të vihen në dispozicion për inspektim publik as paraqitja e disenjos dhe as dosjet që lidhen me kërkesën, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga dispozitat e legjislacionit në fuqi, që mbrojnë interesat e ligjshëm të palëve të treta.
3. Në përfundim të periudhës së shtyrjes apo në çfarëdo date më të hershme, të kërkuar nga mbajtësi i së drejtës, DPPI-ja vë në dispozicion për inspektim publik të gjitha regjistrimet në regjistrin e saj dhe dosjen që lidhet me kërkesën, si dhe boton disenjon e regjistruar.
4. Mbajtësi i së drejtës mund të mos e lejojë botimin e disenjos së regjistruar, siç përmendet në pikën 3 të këtij neni, duke paraqitur një kërkesë për heqjen dorë nga disenjoja e regjistruar.

Neni 27
Korrigjimi i gabimeve dhe i pasaktësive të dukshme

1. Kur DPPI-ja ka marrë një vendim ose ka nxjerrë një akt administrativ në lidhje me një disenjo, i cili përmban një gabim të dukshëm të bërë nga vetë DPPI-ja, me kërkesë të palëve të interesuara ose me iniciativë të DPPI-së, kjo e fundit mund të korrigjojë ose të ndryshojë aktin administrativ.
2. DPPI-ja merr vendim brenda 2 muajve për kërkesën e paraqitur, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe njofton palët për vendimin e marrë.
3. Kundër vendimit të marrë nga DPPI-ja, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të bëhet ankim në bordin e apelit, përkundrejt pagesës së tarifës përkatëse, brenda 1 muaji nga data që vendimi u njoftohet palëve.

KREU III
EFEKTET E REGJISTRIMIT TË DISENJOS

Neni 28
Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi i disenjos

1. Regjistrimi i një disenjoje i jep mbajtësit të të drejtave të saj të drejtën ekskluzive për ta përdorur atë dhe për të mos lejuar përdorimin e saj nga palë të treta, që nuk kanë marrë pëlqimin e tij.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij neni, ndalohet si më poshtë:
a) krijimi, ofrimi, hedhja në treg ose përdorimi i një produkti në të cilin përfshihet ose për të cilin kërkohet disenjoja;
b) importi ose eksporti i një produkti të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike;
c) magazinimi i një produkti të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike, për qëllimet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike;
ç) krijimi, shkarkimi, kopjimi dhe shpërndarja ose përhapja tek të tjerët e ndonjë mjeti ose *software*-i, ku është regjistruar disenjoja, me qëllim mundësimin e krijimit të një produkti të përmendur në shkronjën "a" të kësaj pike.

3. Mbrojtja që sigurohet nga një disenjo përfshin çdo disenjo që nuk krijon një përshtypje të ndryshme në tërësi te përdoruesi i informuar. Në vlerësimin e fushës së mbrojtjes duhet të merret parasysh shkalla e lirisë së krijuesit në zhvillimin e disenjos.

4. Mbajtësi i së drejtës së një disenjoje të regjistruar ka të drejtën të ndalojë palët e treta që të sjellin drejt territorit të Republikës së Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare produkte nga vendet e treta, të cilat nuk janë lëshuar për qarkullim të lirë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse:

a) disenjoja është përfshirë në këto produkte apo kërkohet për to në mënyrë identike; ose

b) disenjoja nuk dallon në aspektet e saj thelbësore nga këto produkte; dhe

c) mbajtësi i së drejtës nuk ka dhënë autorizim.

5. E drejta e përmendur në pikën 4 të këtij neni përfundon nëse gjatë procedimeve për të vlerësuar nëse ka pasur shkelje të së drejtës së disenjos së regjistruar, të filluara në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi, deklaruesi ose zotëruesi i produkteve provon se mbajtësi i së drejtës së disenjos së regjistruar nuk ka të drejtë të ndalojë hedhjen në treg të produkteve në shtetin e destinacionit përfundimtar.

Neni 29

Kufizimi i të drejtave që jepen nga e drejta e disenjos

1. Të drejtat që jepen nga një e drejtë e disenjos pas regjistrimit të saj nuk ushtrohen për:

a) veprimet që kryhen privatisht dhe për qëllime jotregtare;

b) veprimet që kryhen për qëllime eksperimentale;

c) veprimet e riprodhimit për qëllime citimi ose mësimdhënieje;

ç) veprimet që kryhen me qëllim identifikimin ose referimin ndaj një produkti, si produkt që i përket mbajtësit të së drejtave të disenjos;

d) veprimet që kryhen për qëllime komentimi, kritike ose parodie;

dh) pajisjet e anijeve dhe avionëve të regjistruar në një shtet tjetër, kur këta hyjnë përkohësisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) importin në territorin e Republikës së Shqipërisë të pjesëve rezervë dhe aksesorëve për qëllime të riparimit të anijeve dhe avionëve, të përmendur në shkronjën "dh" të kësaj pike;

ë) kryerjen e riparimeve në anijet dhe avionët e përmendur në shkronjën "dh" të kësaj pike.

2. Shkronjat "c", "ç" dhe "d", të pikës 1 të këtij neni zbatohen vetëm kur veprimet janë në përputhje me praktikat e tregtisë së ndershme dhe nuk cenojnë padrejtësisht shfrytëzimin të disenjos, si dhe në rastin e përmendur në shkronjën "c" të këtij neni, edhe kur përmendet burimi i produktit në të cilin është përfshirë disenjoja ose për të cilin aplikohet disenjoja.

3. Një disenjoje të regjistruar, që është pjesë përbërëse e një produkti kompleks, nga pamja e të cilit varet disenjoja e pjesës përbërëse, dhe që përdoret në kuptimin e pikës 1, të nenit 28 të këtij ligji, nuk i jepet mbrojtje për qëllimin e vetëm të riparimit të atij produkti kompleks për të rikthyer pamjen e tij fillestare.

4. Pika 3 e këtij neni nuk vihet në zbatim nga prodhuesi ose nga shitësi i një pjese përbërëse të një produkti kompleks, i cili nuk i ka informuar siç duhet konsumatorët përmes një treguesi të qartë e të dukshëm për produktin ose në një formë tjetër të përshtatshme për origjinën tregtare dhe identitetin e prodhuesit të produktit, i cili do të përdoret për qëllime të riparimit të produktit kompleks, në mënyrë që ata të mund të bëjnë një zgjedhje të informuar midis produkteve konkurruese që mund të përdoren për riparimin.

5. Prodhuesi ose shitësi i një pjese përbërëse të një produkti kompleks nuk është i detyruar të garantojë që pjesët përbërëse që ai prodhon ose shet të përdoren përfundimisht nga përdoruesit fundorë vetëm për qëllime të riparimit për rikthimin e pamjes fillestare të produktit kompleks.

Neni 30

Shterimi i të drejtave

1.Të drejtat e fituara nga një disenjo nuk shtrihen mbi një produkt në të cilin është përfshirë ose që ka të aplikuar një disenjo të regjistruar kur produkti është vendosur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë nga mbajtësi i disenjos ose me pëlqimin e tij.

2. Të drejtat e fituara nga një disenjo nuk shtrihen mbi një produkt në të cilin është përfshirë ose që ka të aplikuar një disenjo të regjistruar kur produkti është vendosur në treg në territorin e Bashkimit Evropian nga mbajtësi i disenjos ose me pëlqimin e tij.

Neni 31

Të drejtat e përdorimit më të hershëm në lidhje me të drejtat e një disenjoje të regjistruar

1. E drejta e përdorimit më të hershëm i njihet çdo pale të tretë që mund të vërtetojë se përpara datës së paraqitjes së kërkesës për regjistrim ose, në rast kërkese për prioritet, përpara datës së prioritetit, ajo ka filluar me mirëbesim përdorimin e disenjos brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

E drejta njihet edhe nëse pala e tretë ka kryer përgatitje serioze dhe efektive për përdorimin e saj përpara këtyre datave.

Disenjoja që përdoret ose për të cilën janë bërë përgatitjet duhet të jetë e përfshirë brenda fushëveprimit të mbrojtjes së një të drejte disenjoje të regjistruar, e cila nuk është kopjuar nga kjo e fundit.

2. E drejta e përdorimit më të hershëm, e përmendur në pikën 1 të këtij neni, e autorizon palën e tretë që ta përdorë disenjon për qëllimet për të cilat ajo është përdorur tashmë në praktikë ose për të cilat janë bërë përgatitje serioze dhe efektive përpara depozitimit të kërkesës ose datës së prioritetit të së drejtës së disenjos së regjistruar.

Neni 32

Marrëdhënia me format e tjera të mbrojtjes

1. Ky ligj nuk cenon asnjë dispozitë të legjislacionit shqiptar të përafruar me atë të Bashkimit Evropian për markat tregtare apo shenjat e tjera dalluese, patentat dhe modelet e përdorimit, llojet e shkrimit tipografik, përgjegjësinë civile apo konkurrencën e pandershme.

2. Një disenjo e regjistruar në përputhje me këtë ligj gëzon gjithashtu të drejtën për mbrojtje nga e drejta e autorit, duke nisur nga data kur disenjoja është krijuar ose është materializuar në çfarëdolloj forme, me kusht që të përmbushen parashikimet e legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit.

Neni 33

Kohëzgjatja dhe ripërtëritja e regjistrimit të disenjos

1. Regjistrimi i një disenjoje është i vlefshëm për 5 vjet, duke filluar nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e saj.

2. Regjistrimi i një disenjoje mund të ripërtërihet me kërkesë të mbajtësit të së drejtave të disenjos ose të çdo personi të autorizuar kundrejt një pagese të caktuar për një periudhë shtesë prej 5 vjetësh deri në një periudhë prej 25 vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e disenjos.

3. DPPI-ja njofton mbajtësin e së drejtës së disenjos së regjistruar për përfundimin e afatit të regjistrimit të paktën 6 muaj përpara përfundimit të këtij afati. Sidoqoftë DPPI-ja nuk mban përgjegjësi në rast të pamundësisë së njoftimit dhe mungesa e njoftimit nuk ndikon në përfundimin e regjistrimit.

4. Paraqitja e kërkesës për ripërtëritje dhe pagesa e tarifës së ripërtëritjes bëhen të paktën 6 muaj përpara datës së mbarimit të afatit të mbrojtjes së disenjos. Data e mbarimit të afatit të mbrojtjes së disenjos është dita e fundit e afatit për paraqitjen e kërkesës për ripërtëritje kundrejt pagesës së ripërtëritjes.

5. Në rast se kërkesa për ripërtëritje nuk depozitohet brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, ajo mund të paraqitet brenda një periudhe shtesë prej 6 muajsh nga data e përfundimit të afatit të mbrojtjes së disenjos. Në këtë rast tarifa e ripërtëritjes dhe tarifa për depozitim jashtë afatit, të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, paguhen brenda kësaj periudhe shtesë.

6. Në rastin e një regjistrimi të shumëfishtë, kur tarifa e paguar e ripërtëritjes është e pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha disenjot për të cilat kërkohet ripërtëritja, regjistrimi ripërtërihet për ato disenjo që shuma e paguar synon qartazi të mbulojë.

7. Kërkesa për ripërtëritje, e përmendur në pikën 2 të këtij neni, përfshin të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e kërkuesit që kërkon ripërtëritjen;

b) numrin e regjistrimit të disenjos për të cilën paraqitet kërkesa;

c) në rastin e një kërkese për ripërtëritjen e pjesshme të një disenjoje të shumëfishtë, një tregues që identifikon disenjot për të cilat kërkohet ripërtëritja;

ç) pagesën e tarifës së ripërtëritjes.

8. Ripërtëritja hyn në fuqi një ditë pas datës në të cilën përfundon afati i regjistrimit ekzistues. Ripërtëritja regjistrohet në regjistrin e disenjove.

9. Të dhënat e hollësishme që duhet të jepen në kërkesën për ripërtëritjen e disenjos dhe procedurat për ripërtëritjen e saj parashikohen në rregulloren për disenjot.

Neni 34

Licencimi

1. Një disenjo e regjistruar mund të licencohet sipas një licence që mund të jetë ekskluzive ose joekskluzive.

2. Marrëveshja e licencimit bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët, në të kundërt, ajo është e pavlefshme.

3. Mbajtësi i të drejtave të disenjos mund të ushtrojë të drejtat që rrjedhin nga disenjoja kundër të licencuarit, që shkel ndonjë nga kushtet e kontratës së licencës në lidhje me:

a) kohëzgjatjen e licencës;

b) formën në të cilën disenjoja mund të përdoret;

c) listën e produkteve për të cilat jepet licenca;

ç) cilësinë e produkteve të prodhuara nga i licencuari në bazë të licencës.

4. Marrëveshja e licencimit regjistrohet në DPPI, në regjistrin e disenjove, kundrejt pagesës së një tarife të caktuar. I licencuari ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për kontratën e licencës vetëm pasi marrëveshja të jetë regjistruar në regjistrin e disenjove.

5. Kërkesa për regjistrimin e licencës paraqitet në DPPI nga secila prej palëve të interesuara dhe shoqërohet me marrëveshjen e nënshkruar nga palët përpara noterit.

6. Pa cenuar dispozitat e marrëveshjes së licencimit, i licencuari mund të fillojë procesin ligjor kundër cenimit të disenjos vetëm në rast se licencuesi jep pëlqimin e tij. Në rastin e licencës ekskluzive, mbajtësi i licencës ekskluzive mund ta fillojë këtë proces ligjor nëse licencuesi, pasi është njoftuar me shkrim nga i licencuari ekskluziv, nuk e fillon vetë procesin ligjor kundër shkeljes së disenjos brenda 3 muajve nga data që ka marrë njoftimin formal.

7. Për qëllime të marrjes së shpërblimit të dëmit të pësuar, i licencuari ka të drejtë të ndërhyjë në procesin kundër shkeljes së të drejtave të filluar nga licencuesi në përputhje me pikën 6 të këtij neni.

8. Marrëveshja e licencimit mund të nënlicencohet te palët e treta kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjen e licencimit ose me pëlqimin me shkrim të licencuesit. Kur parashikohet në kontratën e licencës, i licencuari mund të japë një nënlicencë dhe parashikimet në këtë ligj për licencuesin ose të licencuarin përfshijnë edhe nënlicencuesin ose të nënlicencuarin.

9. Me kërkesë të njërës nga palët, regjistrimi i marrëveshjes së licencimit, sipas pikës 3 të këtij neni, mund të ndryshohet ose të shfuqizohet.

10. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e marrëveshjes së licencimit, si dhe për ndryshimin apo shfuqizimin e saj parashikohen në rregulloren për disenjot.

Neni 35

Regjistrimi i të drejtave reale në regjistër

1. Disenjoja e regjistruar mund të vendoset si garanci dhe të jetë objekt i të drejtave reale në mënyrë të pavarur nga subjekti tregtar.

2. Me kërkesë të njërës prej palëve, të drejtat që përcaktohen në pikën 1 të këtij neni ose transferimi i këtyre të drejtave regjistrohen në regjistër kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. Çdo regjistrim që bëhet sipas këtij neni botohet në buletinin e DPPI-së.

4. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e të drejtave reale, dokumentet bashkëlidhur, modifikimi apo shfuqizimi përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 36

Regjistrimi i masave të veprimeve përmbarimore në regjistër

1. Disenjoja e regjistruar mund të sigurohet dhe të jetë objekt i masave të veprimeve përmbarimore.

2. Me kërkesën e njërës nga palët, të shoqëruar me pagesën e tarifës përkatëse, një veprim përmbarimor, i marrë ndaj një disenjoje, regjistrohet në regjistrin e disenjove dhe publikohet në buletinin e DPPI-së.

3. Një veprim përmbarimor krijon pasoja juridike vetëm pas regjistrimit të veprimit përmbarimor në regjistrin e disenjove.

4. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e një veprimi përmbarimor përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 37

Regjistrimi i informacionit të procedurës së paaftësisë paguese në regjistër

1. Informacioni për fillimin e procedurës së paaftësisë paguese të një ndërmarrjeje mbajtëse të të drejtave të disenjos së regjistruar regjistrohet në regjistrin e DPPI-së bazuar në njoftimin e bërë nga autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi për falimentimin ose me kërkesë të administratorit të procedurës së paaftësisë paguese.

2. Me kërkesë të personit të interesuar, informacioni për fillimin e procedurës së paaftësisë paguese regjistrohet në regjistër kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.

3. Çdo regjistrim që bëhet sipas këtij neni botohet në buletinin e DPPI-së.

4. Procedura, përmbajtja e kërkesës për regjistrimin e informacionit të procedurës së paaftësisë paguese dhe dokumentet bashkëlidhur, si dhe modifikimi apo shfuqizimi përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 38

Ndryshimi i emrit dhe/ose adresës

1. DPPI-ja, me kërkesë të mbajtësit së të drejtës së disenjos, regjistron ndryshimet në emrin dhe/ose adresën e mbajtësit të së drejtës së disenjos nëse ky ndryshim nuk është pasojë e një transferimi sipas nenit 39 të këtij ligji.

2. Dispozitat e përcaktuara në këtë nen zbatohen edhe për ndryshimin e emrit ose adresës së përfaqësuesit të autorizuar.

3. Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e ndryshimeve të emrit dhe/ose adresës parashikohen në rregulloren për disenjot.

Neni 39

Transferimi i pronësisë

1.Transferimi i pronësisë së disenjos së regjistruar bëhet nëpërmjet një marrëveshjeje të nënshkruar nga të dyja palët, përveçse kur ky transferim pronësie është rezultat i një vendimi gjyqësor sipas pikës 5 të nenit 42 të këtij ligji. Në rast të kundërt, transferimi është i pavlefshëm.

2.Të drejtat për disenjon mund të transferohen së bashku me veprimtarinë e biznesit ose pa e transferuar këtë të fundit.

3.Mund të depozitohet një kërkesë e vetme për regjistrimin e transferimit të dy ose më shumë disenjove të regjistruara, me kusht që mbajtësi i të drejtave dhe përfituesi i transferimit të jenë të njëjtë për të gjitha këto disenjo të regjistruara.

4.Me kërkesë të njërës nga palët, transferimi i disenjos do të regjistrohet në regjistër kundrejt pagesës së tarifës përkatëse dhe do të publikohet në buletinin e DPPI-së. Për sa kohë që transferimi nuk është regjistruar në regjistër, përfituesi i transferimit nuk mund të pretendojë të drejtat që burojnë nga regjistrimi i disenjos.

5.Kërkesa për regjistrimin e transferimit të disenjos në regjistër duhet të përmbajë informacion që identifikon disenjon e regjistruar, mbajtësin e ri të të drejtave dhe, nëse është e zbatueshme, përfaqësuesin e mbajtësit të ri, si dhe marrëveshjen e shkruar midis palëve, që vërteton transferimin, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

6.Kërkesa për regjistrimin e transferimit paraqitet në DPPI nga secila prej palëve të interesuara dhe shoqërohet me marrëveshjen e nënshkruar nga palët përpara noterit.

7.Të dhënat për depozitimin e kërkesës dhe procedura për regjistrimin e transferimit të pronësisë parashikohen në rregulloren për disenjot.

Neni 40

Efektet ndaj palëve të treta

1.Veprimet ligjore, të përmendura nga nenet 34 deri në 39 të këtij ligji, që lidhen me një disenjo të regjistruar, prodhojnë efekt ndaj palëve të treta vetëm pas regjistrimit të tyre në regjistrin e disenjove. Megjithatë një veprim i tillë, edhe para regjistrimit, prodhon efekt ndaj palëve të treta që kanë fituar të drejta për disenjon pas datës së atij veprimi dhe që në momentin e fitimit të së drejtës kishin dijeni për ekzistencën e veprimit.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet ndaj një personi që ka fituar të drejtën për disenjon ose një të drejtë të lidhur me të përmes transferimit të të gjithë ndërmarrjes ose përmes trashëgimisë së plotë në përputhje me ligjin.

3. Efektet ndaj palëve të treta të veprimeve juridike, të përmendura në nenet 36 dhe 37 të këtij ligji, rregullohen edhe nga legjislacioni në fuqi për të drejtat e pronësisë dhe paaftësinë paguese.

4. Efektet ndaj falimentit ose procedimet e ngjashme ndaj palëve të treta rregullohen nga legjislacioni në fuqi i fushës përkatëse.

KREU IV

HEQJA DORË DHE PAVLEFSHMËRIA

Neni 41

Heqja dorë nga një disenjo

1. Për të hequr dorë nga regjistrimi i një disenjoje, mbajtësi i të drejtave të disenjos duhet t'i paraqesë DPPI-së një deklaratë me shkrim, të shoqëruar me autorizimin e përfaqësimit dhe dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse. Heqja dorë nga disenjoja e regjistruar hyn në fuqi në datën e regjistrimit në regjistër. Nëse regjistrimi është bërë për një disenjo të shumëfishtë, heqja dorë bëhet për të gjitha ose për disa prej tyre.

2. DPPI-ja regjistron heqjen dorë nga disenjoja dhe e publikon atë. Nëse për disenjon për të cilën kërkohet dorëheqja është regjistruar një kontratë licence, dorëheqja regjistrohet nga DPPI-ja vetëm pasi mbajtësi i së drejtës së disenjos provon se i licencuari është në dijeni për këtë veprim. Regjistrimi i heqjes dorë bëhet pas përfundimit të periudhës tremujore pas datës në të cilën mbajtësi i së drejtës provon që i licencuari është informuar për qëllimin e heqjes dorë. Në rast se i licencuari ka dhënë pëlqimin e tij të dokumentuar për heqjen dorë nga disenjoja, para përfundimit të afatit 3-mujor nga marrja dijeni, për qëllimin e mbajtësit të së drejtës, DPPI-ja e regjistron menjëherë në regjistër heqjen dorë nga disenjoja dhe e boton atë në buletin.

3. Nëse për disenjon për të cilën kërkohet heqja dorë ka filluar një procedurë gjyqësore për të drejtën për mbrojtjen e saj, parashikuar në nenin 8 të këtij ligji, dorëheqja nuk mund të regjistrohet nga DPPI-ja pa miratimin e paditësit.

4. Nëse kërkesa për dorëheqje nuk përmbush kriteret e përcaktuara në këtë nen, DPPI-ja njofton mbajtësin e së drejtës së disenjos për plotësimin e të metave brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit. Nëse të metat nuk plotësohen brenda afatit të caktuar, DPPI-ja e refuzon kërkesën për dorëheqje.

Neni 42
Pavlefshmëria e disenjos

1. Një disenjo e regjistruar shpallet e pavlefshme me vendim gjykate nëse plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) disenjoja nuk plotëson kushtet e pikës 5 të nenit 4 të këtij ligji;

b) disenjoja nuk përmbush kërkesat e parashikuara në nenet 5 deri në 7 të këtij ligji;

c) disenjoja është në kundërshtim me shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 11 të këtij ligji;

ç) disenjoja është në kundërshtim me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 11 të këtij ligji;

d) me anë të vendimit të gjykatës apo autoriteti kompetent, mbajtësi i të drejtave të disenjos nuk ka të drejtë mbi të sipas ligjit në fuqi;

dh) disenjoja bie ndesh me një disenjo më të hershme, që i është bërë e njohur publikut përpara ose pas datës së depozitimit të kërkesës ose, kur pretendohet për prioritet, përpara ose pas datës së prioritetit të disenjos, dhe që mbrohet duke filluar nga një datë përpara datës së depozitimit të kërkesës ose, kur pretendohet për prioritet, përpara datës së prioritetit të disenjos, nga:

i. një disenjo e regjistruar ose nga një kërkesë për regjistrim të disenjos, me kusht që të regjistrohet;

ii. një disenjo e regjistruar e Bashkimit Evropian ose nga një kërkesë për regjistrim të disenjos të Bashkimit Evropian, me kusht që të regjistrohet;

iii. një disenjo e regjistruar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, ose nga një kërkesë për regjistrim të disenjos, me kusht që të regjistrohet.

e) kur një shenjë dalluese përdoret në një disenjo të mëvonshme dhe legjislacioni që mbron atë shenjë i jep të drejtë mbajtësit të shenjës të ndalojë përdorimin e saj;

ë) disenjoja përbën përdorim të paautorizuar të një vepre, që mbrohet nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e autorit.

2. Nëse disenjoja është regjistruar, e drejta për disenjon do të shpallet e pavlefshme në rast se disenjoja përmban riprodhim të plotë ose të pjesshëm të elementeve që i përkasin trashëgimisë kulturore me rëndësi kombëtare, pa autorizimin nga autoritetet përkatëse.

3. Pavlefshmëria për shkaqet e përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni mund të kërkohet nga:

a) çdo person fizik ose juridik; ose

b) çdo grup ose organ i ngritur, me qëllim përfaqësimin e interesave të prodhuesve, furnizuesve të shërbimeve, tregtarëve ose konsumatorëve, nëse ky grup ose organ ka aftësinë juridike në bazë të ligjit.

4. Pavlefshmëria për shkakun e përmendur në shkronjën "c", të pikës 1 të këtij neni, mund të pretendohet vetëm nga personi ose nga subjekti i prekur nga përdorimi i papërshtatshëm.

5. Pavlefshmëria për shkakun e përmendur në shkronjën "d" të pikës 1 të këtij neni pretendohet vetëm nga mbajtësi i së drejtave të disenjos sipas ligjit në fuqi. Në këtë rast, mbajtësi i pretenduar i të drejtës së disenjos ka të drejtë që në vend të kërkesës për pavlefshmëri, të kërkojë transferimin e regjistrimit në emër të tij.

6. Shkaqet për pavlefshmërinë, të parashikuara në shkronjat "dh", "e" dhe "ë", të pikës 1 të këtij neni mund të pretendohen vetëm, nga:

a) kërkuesi ose mbajtësi i të drejtave të mëparshme;

b) personat që janë të autorizuar ta ushtrojnë të drejtën në bazë të legjislacionit në fuqi; ose

c) një i licencuar i autorizuar nga mbajtësi i të drejtave të mëparshme.

7. Një disenjo e regjistruar nuk shpallet e pavlefshme kur kërkuesi ose mbajtësi i një të drejte, siç përmendet në shkronjat "dh", "e" dhe "ë", të pikës 1 të këtij neni, ka dhënë shprehimisht pëlqimin për

regjistrimin e disenjos përpara se të depozitojë kërkesën për deklarimin e pavlefshmërisë apo kundërpadinë.

8. Disenjoja mund të shpallet e pavlefshme edhe pasi ka kaluar afati i mbrojtjes ose pasi është ushtruar e drejta e heqjes dorë nga disenjoja, nëse kërkuesi tregon një interes të ligjshëm për të marrë një vendim për çështjen.

9. Pavlefshmëria kërkohet në gjykatën kompetente sipas rregullave të procedurës civile. Një disenjo që është shpallur e pavlefshme konsiderohet se nuk ka sjellë pasoja që nga fillimi

10. Pavarësisht nga pika 9 e këtij neni dhe pa cenuar dispozitat e ligjit shqiptar, që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar nga neglizhenca ose nga mungesa e mirëbesimit të mbajtësit të disenjos, si edhe me pasurimin e padrejtë, efekti prapaveprues i pavlefshmërisë së disenjos nuk prek:

a) asnjë vendim gjyqësor për shkelje të të drejtave, i cili ka marrë formë të prerë dhe është zbatuar përpara datës së shpalljes së pavlefshmërisë;

b) asnjë kontratë të lidhur para datës së pavlefshmërisë, për aq kohë sa ajo është ekzekutuar përpara shpalljes së pavlefshmërisë. Megjithatë, për arsye barazie ndërmjet palëve në kontratë, mund të kërkohet rimbursimi i shumave të paguara në një masë të arsyeshme dhe të justifikuar nga rrethanat.

Neni 43

Objekti i mbrojtjes

1. Objekti i mbrojtjes së një disenjoje të regjistruar përfshin çdo disenjo që nuk krijon te përdoruesi i informuar një përshtypje të përgjithshme të ndryshme.

2. Në vlerësimin e objektit të mbrojtjes merret parasysh shkalla e lirisë së krijuesit të disenjos në zhvillimin e disenjos së tij.

PJESA III

REGJISTRIMI NDËRKOMBËTAR I DISENJOS

Neni 44

Zbatimi i dispozitave sipas marrëveshjes së Hagës

1. Kërkesat për regjistrim ndërkombëtar të disenjos depozitohen në zyrën ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, në përputhje me marrëveshjen e Hagës "Mbi regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale" dhe me rregullat e nxjerra në zbatim të saj.

2. Në përputhje me nenin 8 të marrëveshje së Hagës, dispozitat e këtij ligji për mbrojtjen e një disenjoje në Republikën e Shqipërisë zbatohen në të njëjtën mënyrë.

3. Procedurat e lidhura me kërkesat për regjistrim ndërkombëtar të disenjos përcaktohen në rregulloren për disenjot.

Neni 45

Ekzaminimi i kërkesës për regjistrim ndërkombëtar të disenjos në DPPI, si zyrë pritëse

1. Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar përmban elementet e përcaktuara në nenin 5 të marrëveshjes së Hagës dhe nënshkruhet nga kërkuesi ose përfaqësuesi i tij.

2. Të gjitha elementet e një kërkese për regjistrim ndërkombëtar të depozituar në DPPI plotësohen në formularin *online* në portalin qeveritar "*e-Albania*" dhe në formularin e dhënë nga zyra ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

3. Kur kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të disenjos është në përputhje me kërkesat e përcaktuara, DPPI-ja miraton, shënon datën e marrjes së kërkesës dhe ia përcjell zyrës ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.

4. Nëse kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të disenjos ndërkombëtare nuk i plotëson elementet e përcaktuara në nenet 44 dhe 45 të këtij ligji, DPPI-ja i dërgon njoftim kërkuesit që të plotësojë të metat ose mangësitë brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.

5. Nëse kërkuesi nuk plotëson të metat ose mangësitë brenda afatit të caktuar, DPPI-ja, si zyrë pritëse, vendos për refuzimin e përcjelljes së kërkesës për regjistrim ndërkombëtar të disenjos.

Neni 46
Data e regjistrimit të depozitimit ndërkombëtar

1. Regjistrimi i depozitimit ndërkombëtar do të bëhet nga zyra ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale.
2. Data në të cilën zyra ndërkombëtare e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale ka marrë kërkesën ndërkombëtare në formën e duhur dhe tarifat përkatëse do të konsiderohet si data e regjistrimit të depozitimit

Neni 47
Pranimi i një kërkese për regjistrim ndërkombëtar në DPPI, si zyrë e caktuar ose si zyrë e përzgjedhur

1. Në rastin kur është zgjedhur Republika e Shqipërisë për shtrirjen e mbrojtjes së një disenjoje, DPPI-ja e pranon kërkesën për regjistrim ndërkombëtar dhe e kalon kërkesën në fazë kombëtare.
2. Procedura e ekzaminimit të një kërkese, që plotëson kushtet e pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 48
Tarifat për kërkesat në lidhje me disenjot ndërkombëtare

1.Çdo tarifë për përcjelljen e një kërkese të lidhur me disenjot në zyrën ndërkombëtare paguhet drejtpërdrejt për DPPI-në në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave.
2.Çdo tarifë e pagueshme për zyrën ndërkombëtare, sipas marrëveshjes së Hagës, paguhet sipas kësaj të fundit.

Neni 49
Kohëzgjatja e mbrojtjes

Mbrojtja e disenjos ndërkombëtare fillon në datën e depozitimit ndërkombëtar dhe përfundon sipas parashikimit të nenit 17 të marrëveshjes së Hagës.

Neni 50
Komunikimi me zyrën ndërkombëtare

DPPI-ja komunikon me zyrën ndërkombëtare në mënyrën dhe formatin e rënë dakord ndërmjet tyre dhe mundësisht nëpërmjet mjeteve elektronike.

PJESA IV
PËRFAQËSIMI NË DPPI

Neni 51
Komunikimi dhe përfaqësimi në DPPI

1. Palët në procedurë ose, sipas rastit, përfaqësuesit e tyre do të caktojnë një adresë zyrtare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo komunikim zyrtar me DPPI-në.

2. Pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, adresa zyrtare mund të jetë edhe në territorin e Zonës Ekonomike Evropiane.

3. Personat që nuk kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, mund të përfaqësohen në DPPI vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për disenjot, të certifikuar dhe të regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

4. Personat që kanë vendbanimin, selinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar ose një degë apo zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar për disenjot, të certifikuar dhe të regjistruar si të tillë nga DPPI-ja.

5. Personat mund të autorizojnë një ose më shumë përfaqësues të autorizuar për disenjot për të kryer një ose të gjitha veprimet në DPPI. Tagrat e përfaqësimit për secilin përfaqësues përcaktohen në autorizimin e përfaqësimit, i cili depozitohet në DPPI për çdo rast.

6.Kërkuesi ose pronari i disenjos mund të ndryshojë përfaqësuesin e tij në regjistrin e disenjove nëpërmjet depozitimit të një kërkese, e cila përmban autorizimin e përfaqësimit për përfaqësuesin e ri dhe pagesën e tarifës përkatëse.

7. Përfaqësuesit e autorizuar për disenjot, që janë certifikuar dhe janë regjistruar si të tillë nga DPPI-ja, mund të hiqen nga regjistri dhe nga lista e përfaqësuesve të autorizuar me kërkesë të tyre. Ndryshimet në listën e përfaqësuesve publikohen.

8. Çdo ndryshim në lidhje me statusin dhe të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar regjistrohen në regjistër dhe botohen në buletinin e DPPI-së.

9. Parimet e përgjithshme të përfaqësimit, procedurat dhe kushtet për certifikimin e përfaqësuesve të autorizuar për disenjot, si dhe rregullat e tjera në lidhje me përfaqësimin në DPPI përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 52

Kërkesat në format elektronik për shërbimet që ofron DPPI-ja

1. Çdo kërkesë për shërbimet e ofruara nga DPPI-ja depozitohet elektronikisht nëpërmjet portalit "*e-Albania*", në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon shërbimet *online* në Republikën e Shqipërisë.

2.Çdo kërkesë në format elektronik duhet të shoqërohet me nënshkrimin elektronik sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 53

Bashkëpunimi administrativ

1. DPPI-ja bashkëpunon me zyrat qendrore të pronësisë industriale të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të ngarkuara me regjistrimin e disenjove, si dhe me zyrën e Bashkimit Evropian për pronësinë intelektuale (EUIPO), me qëllim promovimin e konvergjencës së praktikave dhe mjeteve në lidhje me ekzaminimin, regjistrimin dhe deklarimin e pavlefshmërisë së disenjove.

2. Përveç fushave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, DPPI-ja bashkëpunon me autoritetet kompetente në të gjitha fushat e veprimtarive të tyre, të cilat janë me rëndësi për mbrojtjen e disenjove në Bashkimin Evropian.

PJESA V

ZBATIMI I TË DREJTAVE

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 54

Juridiksioni gjyqësor

1. Ankimet kundër vendimeve të bordit të apelit të DPPI-së, sipas këtij ligji, depozitohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga data e marrjes së vendimit të arsyetuar.

2. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka juridiksion për të gjitha çështjet e tjera, duke përfshirë:

a) të gjitha veprimet që lidhen me shkeljen e të drejtave të disenjos dhe veprimet që rrezikojnë shkeljen e këtyre të drejtave;

b) veprimet që lidhen me deklarimin e pavlefshmërisë së disenjos së regjistruar, sipas kërkesave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 55
Normat e zbatueshme

1. Mjetet, masat dhe procedurat ligjore, që parashikohen në këtë ligj, zbatohen në lidhje me shkeljen e të drejtave të disenjos, pa cenuar mjetet e tjera ligjore, që janë parashikuar në legjislacionin kombëtar.

2. Ky ligj nuk përjashton zbatimin e legjislacionit penal në lidhje me procedurat ose sanksionet penale për shkeljen e të drejtave të disenjos.

Neni 56
Zbatimi i masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse janë:

a) mbajtësit e të drejtave në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) çdo person i autorizuar për të përdorur këto të drejta, duke përfshirë të licencuarin, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 57
Veprime që përbëjnë shkelje të të drejtave të disenjos

Shkelje të së drejtës së disenjos është, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim ose imitim i paautorizuar i disenjos dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas dispozitave të këtij ligji.

KREU II
PROCEDURAT DHE MASAT KUNDËR SHKELJES SË TË DREJTAVE TË DISENJOS

Neni 58
Provat

1. Me qëllim mbrojtjen e informacionit konfidencial, me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj dhe që ka specifikuar provat që janë nën zotërimin e palës tjetër, gjykata kompetente urdhëron që këto prova të paraqiten nga pala kundërshtare.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, gjykata vlerëson çdo provë të paraqitur nga pala kërkuese në lidhje me pretendimet e saj.

3. Me kërkesë të palës, gjykata urdhëron, sipas rastit, paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, të cilat janë në zotërim të palës kundërshtare, me qëllim që të mbrohet informacioni konfidencial.

Neni 59
Masat për sigurimin e provave

1. Me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj për shkeljen ose rrezikun e shkeljes së të drejtave të disenjos, gjykata urdhëron marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për sigurimin e provës, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial. Këto masa mund të merren edhe përpara fillimit të procedurave gjyqësore për themelin e çështjes dhe mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm, me ose pa marrjen e mostrave, ndalimin fizik të mallrave cenuese dhe, sipas rastit, të materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin dhe/ose shpërndarjen e këtyre mallrave dhe dokumenteve të lidhura me to. Gjykata vendos për marrjen ose jo të masave për sigurimin e provës brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, si dhe përcakton afatin brenda të cilit duhet të ekzekutohet masa e urdhëruar nëpërmjet këtij vendimi. Ky afat kohor nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

2. Gjykata vendos për marrjen e masave për sigurimin e provës pa dëgjuar palën tjetër, kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund t'i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit së të drejtës ose kur ekziston rreziku të asgjësohet prova.

3. Kur masat për sigurimin e provës vendosen pa dëgjuar palën tjetër, pala kundër së cilës është vendosur masa njoftohet menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

4. Kur masat për sigurimin e provës janë vendosur pa i dhënë mundësi që të dëgjohet palës kundër së cilës është vendosur masa, kjo e fundit ka të drejtë të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të masës.

5. Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave për sigurimin e provës brenda një afati kohor të arsyeshëm, i cili nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

6. Gjykata vendos që marrja e masave për sigurimin e provës të kushtëzohet me depozitimin nga kërkuesi të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barasvlershme, me qëllim që të garantohet ose të sigurohet shpërblimi i çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të padituri sipas pikës 7 të këtij neni.

7. Me kërkesë të të padituri, masat për sigurimin e provës shfuqizohen ose hiqen pa cenuar të drejtën për dëmshpërblim që mund të pretendohet, nëse kërkuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes, brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga gjykata në vendimin e saj për marrjen e masave. Ky afat i arsyeshëm nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike, cilido që është afati më i gjatë, nga data e ekzekutimit të masës për sigurimin e provës.

8. Nëse masat e sigurimit të provës shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të kërkuesit ose nëse është konstatuar më pas se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të disenjos, gjykata urdhëron kërkuesin, me kërkesën e të padituri, që t'i sigurojë këtij të fundit një shpërblim të përshtatshëm për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa.

9. Gjykata merr masa për të mbrojtur identitetin e dëshmitarëve të përfshirë në procedurën për sigurimin e provave.

Neni 60

E drejta për informim

1.Me kërkesë të arsyetuar dhe proporcionale të paditësit, gjykata urdhëron gjatë shqyrtimit të shkeljes së të drejtave të disenjos që informacioni për origjinën dhe rrjetet e shpërndarjes së mallrave dhe shërbimeve, që cenojnë të drejtat e disenjos industriale, të sigurohet nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër që:

a) konstatohet se zotëron mallra cenuese në shkallë tregtare;

b) konstatohet se përdor shërbime që cenojnë të drejtën në shkallë tregtare;

c) konstatohet se ofron shërbime që cenojnë të drejtën në shkallë tregtare; ose

ç) identifikohet nga një prej personave të përcaktuar në shkronjat "a", "b" ose "c" të kësaj pike se është përfshirë në prodhimin, përpunimin ose shpërndarjen e mallrave ose ofrimin e shërbimeve, që cenojnë të drejtat e disenjos industriale.

2. Informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sipas rastit, përfshin:

a) emrat dhe adresat e prodhuesve, përpunuesve, shpërndarësve, furnizuesve, mbajtësve të tjerë të mëparshëm të mallrave ose shërbimeve, si dhe të tregtarëve me shumicë dhe pakicë;

b) informacionin për sasitë e prodhuara, të përpunuara, të shpërndara, të marra ose të porositura, si edhe çmimet e marra për mallrat ose shërbimet në fjalë.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen pa cenuar dispozitat e tjera ligjore në fuqi, të cilat:

a) i njohin të drejtën mbajtësit të së drejtës që të marrë informacion më të plotë;

b) rregullojnë përdorimin e informacionit të siguruar në përputhje me këtë nen në proceset civile ose penale;

c) parashikojnë përgjegjësi për keqpërdorimin e së drejtës për informim;

ç) japin mundësi për refuzimin e dhënies së informacionit kur ky informacion e detyron personin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni që të pranojë pjesëmarrjen e tij ose të familjarëve të tij në shkeljen e të drejtave të disenjos;

d) rregullojnë mbrojtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit ose përpunimin e të dhënave personale.

KREU III
MASAT E PËRKOHSHME

Neni 61
Masat e përkohshme

1. Me kërkesën e personit të interesuar, gjykata vendos:

a) marrjen e masave të përkohshme kundër shkelësit të pretenduar për të parandaluar një shkelje të pritshme të të drejtave të disenjos ose për të ndaluar në mënyrë të përkohshme vazhdimin e shkeljes së pretenduar së të drejtave;

b) ndalimin ose vendosjen nën kontroll të mallrave, që dyshohet se shkelin të drejtat e disenjos, me qëllim që të parandalojë hyrjen ose qarkullimin e tyre në rrjetet e tregtisë.

2. Masat e përkohshme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të vendosen edhe kundër ndërmjetësit, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e disenjos.

3. Gjykata mund të vendosë bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme ose të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, duke përfshirë bllokimin e llogarive të tij bankare dhe të aseteve të tjera, kur pala e dëmtuar demonstron rrethana të tilla që mund të rrezikojnë rikuperimin e dëmeve. Për këtë qëllim, gjykata mund të urdhërojë paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose tregtare, ose shfrytëzimin e mundësive të tjera të përshtatshme për marrjen e informacionit përkatës.

4. Gjykata mund t'i kërkojë kërkuesit prova për masat e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, me qëllim për të vërtetuar se ai është mbajtës i së drejtës dhe se të drejtat e tij janë shkelur ose pritet të shkelen.

5. Gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër, kur është e nevojshme, veçanërisht kur vonesa mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për mbajtësin e së drejtës. Në një rast të tillë, palët informohen menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.

6. Kur masat e përkohshme janë vendosur pa i dhënë mundësi palës, kundër së cilës është vendosur masa, të dëgjohet, kjo e fundit mund të depozitojë një kërkesë në gjykatë për rishikim të masës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të masës së përkohshme. Në procedurat e rishikimit, gjykata u jep mundësi palëve që të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave të përkohshme brenda një afati të arsyeshëm, që nuk duhet të jetë më shumë se 5 ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.

7. Me kërkesë të të paditurit, gjykata vendos shfuqizimin ose heqjen e masave të përkohshme nëse kërkuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda afatit të caktuar nga gjykata në vendimin për marrjen e masave të përkohshme. Ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 20 ditë pune ose 31 ditë kalendarike nga data e ekzekutimit të masës, sipas afatit që është më i gjatë.

8.Gjykata vendos që marrja e masave të përkohshme të kushtëzohet me depozitimin nga kërkuesi të një garancie të përshtatshme ose një mënyrë tjetër sigurimi të barasvlershëm, me qëllim që të garantohet ose të sigurohet shpërblimi i çdo dëmi që mund t'i shkaktohet të paditurit sipas pikës 9 të këtij neni.

9. Nëse masat e përkohshme shfuqizohen, hiqen ose bëhen të pavlefshme për shkak të një veprimi ose mosveprimi të kërkuesit apo nëse pas vendosjes së saj është konstatuar më pas se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të disenjos, gjykata mund të urdhërojë kërkuesin, me kërkesën e të paditurit, që t'i sigurojë këtij të fundit shpërblimin për çdo dëm të shkaktuar nga zbatimi i masës.

KREU IV
PROCEDURAT DHE MASAT KUNDËR SHKELJES SË TË DREJTAVE

Neni 62
Procedurat dhe masat kundër shkeljes së të drejtave

1. Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve mbrojtëse, sipas këtij ligji, mund t'i drejtohen gjykatës për të kërkuar:

a) ndalimin e tregtimit të mallrave dhe/ose ofrimit të shërbimeve, që shkelin të drejtat e disenjos;

b) heqjen nga qarkullimi tregtar dhe/ose konfiskimin e mallrave që cenojnë të drejtën dhe, sipas rastit, të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve; urdhërimin e shkelësit të ndalojë çdo shkelje të mëtejshme të të drejtave të disenjos;

c) ndalimin e vendosjes apo bërjes së disponueshme në treg të mallrave të disenjove të falsifikuara me heqjen ose shkëputjen e disenjove në këto mallra;

ç) shkatërrimin e mallrave që cenojnë të drejtën, si dhe/ose të materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe mjeteve të përdorura kryesisht për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve;

d) botimin e pjesshëm ose të plotë të vendimit të gjykatës në medien publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, sipas mënyrës së parashikuar nga gjykata;

dh) shpërblimin e dëmit të pësuar nga shkelja e të drejtave të disenjos.

2. Gjykata urdhëron zbatimin e masave të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1 të këtij neni, me shpenzimet e shkelësit, përveçse kur ka arsye të veçanta për të vendosur ndryshe. Në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e këtyre masave, gjykata vlerëson proporcionalitetin midis rëndësisë së shkeljes dhe masës së urdhëruar, si dhe interesat legjitim të palëve të treta.

3. Masat e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1 të këtij neni, mund të merren edhe ndaj ndërmjetësit, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e disenjos.

4. Në procedimet lidhur me shkeljet prezumohet në favor të mbajtësit të së drejtës së disenjos së regjistruar se janë përmbushur kërkesat për vlefshmërinë ligjore të një të drejte disenjoje të regjistruar, siç parashikohet nga nenet 5 deri në 7 të këtij ligji, dhe se e drejta e disenjos nuk është regjistruar në kundërshtim me shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 11 të këtij ligji. Ky prezumim i vlefshmërisë është i kundërshtueshëm me çdo lloj mjeti procedural të disponueshëm sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë edhe paraqitjen e një kundërpadie.

5. Padia për shkeljen e të drejtave të disenjos depozitohet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data kur paditësi merr dijeni për shkeljen e pretenduar dhe identitetin e shkelësit të pretenduar.

Neni 63
Shpërblimi i dëmit

1. Me kërkesë të palës së dëmtuar, gjykata urdhëron personin që është përfshirë në veprimtari shkelëse që të paguajë shpërblimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e shkeljes së të drejtave të disenjos.

2. Në përllogaritjen e masës së shpërblimit të dëmit, gjykata mban parasysh çdo dëm efektiv dhe real, duke përfshirë:

a) fitimin e munguar të palës së dëmtuar;

b) çdo përfitim të padrejtë të realizuar nga shkelësi;

c) dëmin moral, që i është shkaktuar palës së dëmtuar nga shkelja, cenimin e emrit dhe reputacionit tregtar.

3. Gjykata, sipas rastit, vendos shpërblimin e menjëhershëm të dëmit nëpërmjet caktimit të një shume monetare për t'u paguar nga shkelësi në favor të palës së dëmtuar. Vendimi i gjykatës bazohet

në elemente të tilla, si fitimet, të ardhurat dhe/ose tarifat, që do të siguroheshin në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizimin për përdorimin e të drejtave të disenjos në fjalë.

4. Kur shkelësi ka vepruar joqëllimisht, ose pa arsye të mjaftueshme për të ditur, duke u përfshirë në veprimtari shkelëse, gjykata urdhëron rikuperimin e fitimeve ose pagesën e dëmeve, të cilat paracaktohen.

Neni 64
Masat në doganë

Kushtet dhe procedurat lidhur me veprimet që ndërmerren nga autoritetet doganore, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelet një e drejtë e disenjos nga mallra, të cilat janë ose duhet të ishin objekt i mbikëqyrjes doganore apo kontrollit doganor, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, rregullohen nga legjislacioni doganor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 65
Masat në tregun e brendshëm

1. Mbajtësi i të drejtave, në kuptim të këtij ligji, mund të paraqesë një kërkesë-ankesë për inspektim tek autoriteti i ngarkuar për mbikëqyrjen e tregut të brendshëm për fillimin e procedurave dhe marrjen e masave përkatëse të inspektimit, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dyshimi se shkelen të drejtat e disenjos nga mallra dhe shërbime, që janë vendosur në treg në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Procedurat për veprimet që ndërmerr autoriteti i ngarkuar me mbikëqyrjen e tregut të brendshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, rregullohen nga legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe nga çdo ligj apo akt nënligjor tjetër, që përmban dispozita për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm.

PJESA VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 66
Mbrojtja e të dhënave personale

Përpunimi i të dhënave personale, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, bëhet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 67
Regjistri i pronësisë industriale i disenjove

1. DPPI-ja në bazën e të dhënave shtetërore për SAPI-n mban dhe administron edhe të dhënat e mëposhtme në lidhje me kërkesat dhe regjistrimet e disenjove:

a) Të dhënat parësore, si:

i. datën e depozitimit të kërkesës;

ii. numrin e kërkesës;

iii. datën e publikimit të kërkesës;

iv. produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën e nënklasën e produktit në përputhje me klasifikimin e Lokarnos;

v. të dhënat e prioritetit (nëse ka);

vi. numrin e disenjove të përfshira në aplikim në rastin e disenjove të shumëfishta;

vii. datën e regjistrimit të disenjos dhe numrin e regjistrimit.

b) Të dhënat dytësore, si:

i. emrin dhe adresën e kërkuesit;

ii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit të kërkuesit.

2. SAPI mban dhe administron edhe shënimet e mëposhtme në lidhje me disenjot së bashku me datën e tyre të regjistrimit:

a) Të dhëna parësore, si:

i. transferimin e pronësisë së disenjos të këtij ligji;

ii. regjistrimet, pavlefshmërinë, modifikimet, dhënien ose transferimin në lidhje me licencat, sipas këtij ligji, dhe, sipas rastit, llojin e licencës;

iii. ripërtëritjen e regjistrimeve të disenjove sipas këtij ligji;

iv. të dhënat për përcaktimin e kohëzgjatjes së regjistrimeve sipas këtij ligji;

v. tërheqjen nga kërkesa për disenjon, heqjen dorë nga disenjoja, si dhe datën e depozitimit, kërkesën për pavlefshmërinë sipas këtij ligji;

vi. datën dhe përmbajtjen e vendimit mbi kundërshtimin, kërkesën për shfuqizim, kërkesën për deklarimin e pavlefshmërisë dhe të ankimeve në bordin e apelit sipas këtij ligji;

vii. korrigjimin e gabimeve dhe pasaktësive të dukshme, çregjistrimin e të dhënave dhe shfuqizimin e vendimeve të DPPI-së;

viii. datën dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, që shtrihen në Republikën e Shqipërisë.

b) Të dhënat dytësore, si:

i. ndryshimet në emër dhe adresë të përfaqësuesit të pronarit të disenjos;

ii. emrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse caktohet një përfaqësues i ri për disenjon.

3. DPPI-ja i dërgon njoftim pronarit të disenjos për çdo ndryshim në regjistër.

4. Përpunimi të dhënave në lidhje me shënimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, përfshirë çdo të dhënë personale, kryhet me qëllim:

a) administrimin e kërkesave dhe regjistrimeve të disenjove, siç përcaktohet në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij;

b) mbajtjen e regjistrit publik për inspektim, si dhe informimin e autoriteteve publike e të operatorëve ekonomikë, në mënyrë që t'u mundësojë atyre të ushtrojnë të drejtat e njohura nga ky ligj dhe të informohen për ekzistencën e të drejtave të mëparshme, që u përkasin palëve të treta;

c) përpilimin e raporteve e të statistikave që i mundësojnë DPPI-së të optimizojë veprimet e saj dhe të përmirësojë funksionimin e sistemit.

5. Çdo e dhënë në lidhje me shënimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni konsiderohet se është me interes publik dhe mund të aksesohet nga çdo palë e tretë, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Për arsye të sigurisë juridike, shënimet në regjistër mbahen për një periudhë kohe të pakufizuar.

Neni 68

Zbatimi i ligjit

1. Në proceset gjyqësore administrative për disenjot zbatohen edhe dispozitat e kodit që rregullon procedurën administrative, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Në proceset gjyqësore civile për disenjot zbatohen edhe dispozitat e kodit që rregullon procedurën civile, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Neni 69

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 1, shkronja "d"; 47, pika 2, dhe 51, pika 9, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të miratojë rregulloren për disenjot në zbatim të neneve 12, pika 1, shkronja "a"; 14, pika 6; 16, pika 4; 22, pika 5; 24, pika 6; 25, pika 2; 33, pika 9; 34, pika 10; 35, pika 4; 36, pika 4; 37, pika 4; 38, pika 3; 39, pika 7; 44, pika 3 dhe 48, pika 1, të këtij ligji.

Neni 70
Dispozita kalimtare

1. Për procedurat e regjistrimit të të drejtave të disenjos, që nuk kanë përfunduar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, dhe të vendimit nr. 270, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industriale".

2. Proceset për shkeljen e të drejtave dhe procedurat administrative, që kanë filluar ose janë pezull përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të trajtohen dhe do të vendosen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, dhe të vendimit nr. 270, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industriale".

3. Deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores për disenjot, që do të nxirret në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, siç parashikohet në nenin 69, pika 2, të tij, do të zbatohen, për aq sa është e mundur, dhe në masën që ato nuk bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, dispozitat e vendimit nr. 270, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores për regjistrimin disenjove industriale" dhe të vendimit nr. 883, datë 13.5.2009, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave për regjistrimin objekteve të pronësisë industriale", i ndryshuar.

4. Aktet nënligjore të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk bien ndesh me të do të zbatohen derisa nuk janë miratuar aktet nënligjore të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

5. Kërkesat dhe procedurat administrative që preken nga ky ligj zbatohen pas përmirësimit të sistemit të administrimit të pronësisë industriale.

Neni 71
Shfuqizime

1. Nenet 112, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 119/a, 120, 121, 121/a, 122, 122/a, 122/b, 123, 124, 124/a, 125, 126, 127, 128, 129, 129/a, 129/b, 130, 131, 137, 138, 139, 184, 184/a, 184/b, 184/c, 184/ç, 185, 185/a, 186, 187 dhe 188, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", i ndryshuar, shfuqizohen, për aq sa parashikohet në lidhje me disenjot industriale, me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Pika 1, e nenit 30 të këtij ligji, shfuqizohet në ditën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Neni 72
Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 9 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht, pika 2 e nenit 30, nënpika "ii", e shkronjës "dh", të pikës 1, të nenit 42 dhe pika 2, e nenit 53 të këtij ligji, hyjnë në fuqi me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Miratuar në datën 18.9.2026.

Shpallur me dekretin nr. , datë .10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj